



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1009/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtri, Mentor Ferizi nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 09.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrri, Mentor Ferizi, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Vushtri, në Vendvotimin: 2713B/05D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimit si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 10.11.2017, nga Mentor Ferizi kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e PDK-së, me të cilën pretendon se në vendvotimin 2713B/05D, në FPR ka pasur 60 vota, ndërsa tani ka vetëm 6 vota. Më tej ka cekur edhe emrin e dëshmitarit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal, në Vushtri, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimin e cekur më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 1009/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.